



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Sesioni pranveror

Komisioni i Shëndetësisë, i Punës dhe i Mirëqenies Sociale

Mbledhja nr. 70

Prishtinë, më 15 qershor 2010, në orën 13: 00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

P R O C E S V E R B A L

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT TË SHËNDETËSISË, TË PUNËS
DHE TË MIRËQENIES SOCIALE**

Në mbledhje morën pjesë: Sadik Idriz, Rita Hajzeraj, Nurishahe Hulaj, Gjylnaze Sylja, Teuta Hadri, Flora Brovina dhe Vezira Emrush.

Mungoi: Qamile Morina.

Të pranishëm: Ilir Tolaj - këshilltar i ministrit të Shëndetësisë, Jeton Shala, u.d. kryeshef i AKPM - së, Blerina Berisha - udhëheqëse e Komisionit për evoluimin e produkteve medicinale, Myesere Hoxha - Lamaxhema, këshilltare e ministrit për Farmaci, Arbenita Pajaziti, shefe për furnizim farmaceutik në MSH, Virtyt Ibrahimaga – ekspert, Shpresa Haxhijaj - administratore e Zyrës së Komisioneve të Kuvendit, Enis Halimi – zyrtar i fushës, Nexhat Shatri – Zyra e Presidentit, Liridon Selmani – KDI dhe Lejla Selimi – OSBE.

Mbledhjen e kryesoi: Sadik Idriz, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës,**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 01.06. 2010,**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit për Produkte dhe Pajisje Medicinale,**
- 4. Të ndryshme.**

***Kryesuesi** konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.*

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 01.06. 2010

Kryesuesi konstatoi se Komisioni i Shëndetësisë, i Punës dhe i Mirëqenies Sociale e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së kaluar.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për Produkte dhe Pajisje Medicinale

Sadik Idriz – Tha se për këtë Projektligj i kemi kaluar afatet dhe kemi kërkuar edhe kohë shtesë. Kemi mbajtur edhe dëgjim publik. Grupi punues ka punuar dhe sot kemi vendosur ta përfundojmë. Mirëpo, ndërkohë, Ministria e Shëndetësisë ka disa vërejtje në versionin e fundit dhe besoj se është mirë t'i dëgjojmë vërejtjet e tyre, në mënyrë që të mos gabojmë dhe të mos kalojmë ligji me ndonjë gabim. Ne do të dëgjojmë sot propozimet e tyre, ndërsa miratimin e amendamenteve do ta shtyjme edhe për një javë, në mënyrë që grupi punues t'i harmonizojë propozimet, nëse vlerëson se janë me vend.

Rita Hajzeraj - Tha se është bërë punë jashtëzakonisht e madhe në këtë Projektligj. Ka qenë Projektligj jashtëzakonisht i vështirë për ta punuar. Jemi munduar që të mbajmë 2 - 3 herë dëgjime publike, dhe të marrim prej secilës palë sugjerimet, dhe t'i fusim në Projektligj. Tani kuptova se nga Ministria është kërkuar një afat shtesë për disa plotësime dhe sugjerime. Pasi Projektligji është shtyrë deri tash, ne u japim afat shtesë deri javën e ardhshme që t'i sjellin propozimet që i kanë. Them kështu duke pasur parasysh ndryshimet që janë bërë në Qeveri, përndryshe nuk do të kishte afat shtesë, sepse që 3 muaj jemi duke punuar dhe ka pasur afat që brenda kësaj kohe t'i sjellin të gjitha propozimet. Ne, si Komision, kemi presion që këtë Projektligj sa më shpejt ta sjellim në Parlamentin e Kosovës. Ju po e shihni se çfarë problemesh po krijohen në AKPM, në Ministrinë e Shëndetësisë, raportet mes tyre, statusi etj. Fjalën ua kaloj anëtarëve të Komisionit që ta shprehin mendimin e tyre lidhur me atë se a pajtohen që të presim edhe një javë ose dhjetë ditë derisa t'i marrim sugjerimet nga Ministria, me qëllim që të mos gabojmë me këtë projektligj.

Gjylnaze Sylaj- Edhe pse nuk e di se cilat janë propozimet e Ministrisë, nuk jam kundër që të mblidhemi dhe, nëse e kanë ndonjë zgjidhje më të mirë se ato që i kemi ofruar ne, ne e inkorporojmë. Në qoftë se grupi punues konsideron që zgjidhja nuk është ajo që ne e kemi menduar, Ministria duhet ta kuptojë se ne e japim vizën e fundit. Nëse kishit mundur, ju doktor, të prezantoni se çka është ideja dhe koncepti i asaj që po e propozoni.

Ilir Tolaj- Tha se i falënderoj anëtarët e Komisionit për mirëkuptim dhe është fakt se ndërrimet që kanë ndodhur në Qeveri dhe në AKPM e kanë bërë një shkëputje në komunikimin tonë me Komisionin dhe jemi vonuar me këto sugjerime. Jemi plotësisht të vetëdijshëm se Komisioni mund të vendosë në mënyrë të pavarur, por mendoj se qëllimi i të gjithë neve është që të kemi ligje të zbatueshëm dhe nuk janë në kundërshti me direktivat e BE - së që e rregullojnë këtë lëmi. Shqetësimi i njerëzve profesionalë të kësaj lëmie është se në draft ka shumë nene që rregullojnë çështje të caktuara, të cilat janë në kundërshtim me direktivat e BE - së dhe se shumë segmente të caktuara nuk rregullohen me draftin e propozuar.

Sadik Idriz - Tha se është mirë që e kemi edhe përfaqësuesit e AKPM - së dhe dy këshilltarët e Ministrisë, pra janë dy pjesë: edhe Agjencia edhe Ministria. Ne po e bëjmë ligjin për këto dy institucione. Shumica e deputetëve nuk janë të kësaj lëmie. Është mirë të bëjmë një ligj të mirë dhe jam i sigurt se shumica e deputetëve janë dakord që ta shtyjme miratimin e amendamenteve për një javë. Këtu e kemi edhe ekspertin, i cili na ka ndihmuar deri më tash dhe besoj se edhe ai do të dëgjojë se çka është çështja, në mënyrë që të mos dalim më një ligj jo të mirë.

Rita Hajzeraj – Tha se meqenëse po e japim një afat shtesë, propozoj që në pjesën tjetër të Projektligjit, aty ku ju nuk jeni dakord, vetëm e shkruani propozim nga Ministria e Shëndetësisë, dhe më pastaj ne, si grup punues, i marrim, i shqyrtojmë dhe ndërkohë mund të bëjmë një takim të përgjithshëm, ku ju i argumentoni ato që i keni propozuar.

Teuta Hadri- Pasi që nga përfaqësuesit e Ministrisë së Shëndetësisë u tha që ka nene që janë në kundërshtim me direktivat e BE - së, kisha dashur që ta japin edhe një lloj arsytimi se cilat janë ato nene në kundërshtim me direktivat e BE - së, që ne ta kemi më të qartë, në mënyrë që mos t'i kundërshtojmë kur të vijmë në shqyrtimin e dytë.

Vezira Emrush- Tha se dëgjova zotërinë nga Ministria se disa pjesë nga ky Projektligj janë në kundërshtim me direktivat e BE - së dhe se Projektligji nuk i mbulon shumë fusha të rëndësishme. Ne dëshirojmë që, si Komision, në formë të shkruar t'i marrim se cilat direktiva të BE - së janë shkelur dhe cilat fusha nuk janë të mbuluara, në mënyrë që ne të mund t'i analizojmë.

Myesere Hoxha- Lamaxhema - Tha se Ligji 2003/26 ka qenë i harmonizuar në tërësi me direktivat e BE - së. Situata ka qenë e tillë që ka qenë e pamundur që t'i implementojmë të gjitha ato direktiva në këtë moment në sistemin e Kosovës që ekziston tash. Për këtë arsye, ideja ka qenë që vetëm t'i bëjmë disa ndërrime sa për t'i thjeshtësuar këto procedura dhe t'i quajmë si procedura nacionale të regjistrimit të barërave, e jo të ndërrohet komplet Ligji i Produkteve dhe Pajisjeve Medicinale.

Arbenita Pajaziti - Në njëfarë forme qëllimi që ka qenë fillimisht ka devijuar dhe po vijmë deri të një ligj, i cili është komplet ndryshe në aspekt të organizimit dhe kompetencave të Agjencisë.

Sadik Idriz- Neve, si Komision dhe Parlament, na ka ardhur propozimi për një Projektligj të ri nga sponsoruesi, që ka qenë Ministria e Shëndetësisë, Qeveria e Kosovës. Ata e kanë përgatitë ndryshimin e Ligjit dhe ne, në Komision, kemi pasur vërejtje dhe kemi pasur pyetje se pse nuk ka ardhur ndryshim - plotësimi i Ligjit ekzistues. Pra, neve na ka ardhur Ligji i ri, edhe pse ne kemi pritur ndryshimin e Ligjit ekzistues, për disa lehtësime, thjeshtësime dhe plotësime.

Flora Brovina- Tha se nuk e di ndonjë Projektligj tjetër, për të cilin kemi punuar aq gjatë sa për këtë të tanishmin. Ndaj mendimin me ata që mendojnë se Komisioni nuk ka profesionistë nga kjo lëmi. Përkundrazi, kujtoj se nuk kemi juristë që të ballafaqohemi, por sa i përket mjekësisë, të gjithë gati jemi të profesionit. Po ashtu, kemi pasur mbështetjen edhe nga juristja dhe nga specialisti i cili ka punuar shumë dhe në vazhdimësi na ka ndihmuar. Kemi punuar në grupe punuese për një kohë shumë të gjatë. E vërtetë është që ndodhën ndryshimet në Qeveri shumë shpejt, por nga ju që jeni të interesuar për Ligjin, dhe e keni sjellë Ligjin në Parlament, pse më herët nuk na i keni sjellë këto sugjerime.

Ilir Tolaj- Tha se pajtohem me ju se ka qenë e nevojshme më herët të bëheshin këto propozime, por duhet ta kuptojmë që këto ndërrime në Qeveri kanë ndodhur vetëm 6 - 7 javë më herët. Edhe ju e dini se kur e merrni një detyrë të re, sa shumë ngarkoheni me lloj - lloj punësh të cilat janë të rëndësishme dhe të parëndësishme ndonjëherë. Sido që të jetë, unë e çmoj këtë mirëkuptim tuajin, duke mos i anashkaluar kritikën që po i bëni, të cilat janë me vend. Tani në një atmosferë më të relaksuar, qoftë në raportet AKPM - Ministri dhe me faktorët e tjerë që e rregullojnë këtë fushë, mund t'i shqyrtojmë në mënyrën më të mirë që ta bëjmë më funksional, pa pretenduar që tash t'i hyjmë një ndryshimi të tërësishëm dhe hudhjes të të gjithë kësaj pune që e keni bërë. Është bërë një punë e mirë, por ka nevojë edhe për sygjerime të profesionistëve të kësaj lëmie, të cilët pa paragjykime do t'i shqyrtojnë shumë nga këto çështje. Propozojmë që të rregullohen disa sfera që nuk janë të rregulluara,

siç janë: çështja e importit të Ministrisë së Shëndetësisë që nuk është e rregulluar fare, të rregullohet çështja e funksionimit të brendshëm të AKPM - së, të rregullohen çështjet që do të duhej të jenë në harmoni me direktivat e BE - së. Të gjitha këto të qiten në formë të shkruar dhe ju t'i shqyrtoni, dhe të jepni një vlerësim tuajin, në bashkëpunim me njërëzit që do t'i propozojnë dhe do t'i arsyetojnë ato. Duke ju falënderuar për këtë mirëkuptim tuajin, zotohemi se do ta shfrytëzojmë këtë kohë për të konsultuar sa më shumë njerëz të vullnetit të mirë dhe të nivelit profesional, që në materialin ekzistues, të fusim gjëra me rëndësi të cilat do ta rregullojnë këtë sferë.

Nurishahe Hulaj- Tha se si Komision duke e ditur se ka pasur shumë probleme në relacionin AKPM - Ministri, kemi vizituar Agjencinë ku jemi njoftuar me problematikën. Për të qenë Ligji më funksional, ne kemi intervenuar dhe është punuar shumë dhe për këtë e falënderoj grupin punues dhe të gjithë anëtarët e tjerë të Komisionit. Konsideroj se është punuar shumë dhe është qartësuar shumë ky ligj. Po më intereson se a keni vërejtje direkt në amendamentet që janë këtu, ose keni amendamente të tjera shtesë. Ne jemi që Ligji të jetë shumë funksional. Ligji të jetë për qytetarët, në mënyrë që bari të arrijë te qytetarët.

Teuta Hadri - Tha se do t'iu lutesha juve që kur t'i sillni amendamentet mos veproni sikur që ju tash do të bëni ndryshime, siç bënë ata para juve që na i kanë humbur 2 - 3 muaj. Kam besim te ju dhe te ministri që nuk do të veproni ashtu si është vepruar. Ligji do të punohet për gjenerata e ardhshme e jo për partitë politike.

Rita Hajzeraj- Tha se vërejtja kryesore që mua më ka ardhur nga Ministria e Shëndetësisë është te neni 4, autoritetet kompetente te Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale dhe organet e AKPM - së. Vërejtja ka qenë se KVPPM është ajo që i lëshon licencat dhe autorizimet dhe të gjitha këto. Ne kemi menduar të mos jetë drejtori i AKPM - së, ai i cili i merr të gjitha vendimet, por ta ketë një këshill i cili i rekomandon. Kisha dashur që të na i sqaroni arsyet.

Arbenita Pajaziti - Ne e kemi parasysh qëllimin tuaj dhe nuk jemi për ta larguar tërësisht KVPPM, por jemi për ta quajtur ndryshe, pasi që roli i këtij komisioni është në vlerësimin e produkteve të cilat aplikojnë për regjistrim në Kosovë, pra është rol këshillëdhënës në aspektin teknik, është Komision profesional - shkencor.

Sadik Idriz- Propozoi që brenda një jave, Ministria e Shëndetësisë t'i sjellë propozimet, në mënyrë që të mos humbim më shumë kohë.

Rita Hajzeraj- Pat një vërejtje për Ministrinë e Shëndetësisë që propozimet t'i sjellin në formë të amendamenteve dhe me arsyetimin pse, e jo vetëm se nuk duhet kjo kështu, e bëni ju tash çka të doni!

Sadik Idriz- Tha se fjalën përfundimtare ne do ta kemi. Lë t'i sjellin vërejtjet, ne do t'i dëgjojmë, në mënyrë që të mos gabojmë diçka, dhe në fund ne e kemi fjalën përfundimtare. Ju si grup punues i krahasoni propozimet që i sjell Ministria dhe në fund të fundit, ne jemi ata që vendosim.

Gjylnaze Sylaj- Tha se në të ardhmen nuk bën që kjo t'i ngjajë Komisionit. Është fyese kjo, sepse e dimë se institucionet duhet të punojnë në mënyrë kontinuele dhe e kanë ditë që Projektligji është në procedurë. Ne punojmë tre muaj në Projektligj dhe në fund të na ndërhyjë Ministria, atëherë në po dalim si servis i Ministrisë. Kërkoj që Komisioni të mos zhvillojë praktika të tilla në të ardhmen.

4. Të ndryshme

Sadik Idriz- Sot është takuar grupi punues i Projektligjit për Punën. Grupi ka marrë vendim që deri në fund të qershorit të mbajmë dëgjim publik për Projektligjin për Punën. Për këtë dëgjim do t'i bëjmë ftesë sindikatave, sponsoruesve, OJQ - ve, pra komplet palëve të interesuara, në mënyrë që të bëjmë një dëgjim publik të zgjeruar.

Nurishahe Hulaj- Qëndrimi im ka qenë dhe do të jetë që deri në fund të korrikut, në seancën e fundit për këtë sesion, ne ta bëjmë gati Projektligjin për miratim. Ne sot kemi mbajtur një takim pune, në mënyrë që t'i informojë anëtarët e grupit punues për të mbajtur një dëgjim publik, ku do të ftohen të gjitha organizatat relevante, në mënyrë që ne t'i marrim idetë, mendimet e tyre edhe me shkrim për t'i bërë amendamentet dhe për ta kompletuar Projektligjin.

Kërkoj dy profesionistë të lartë për ndihmë edhe juridike edhe profesionale. Falënderoj Virytin dhe është mirë që ky të merr pjesë edhe në këtë projektligj, por është mirë ta marrim edhe një tjetër ekspert profesional, qoftë i brendshëm, qoftë i jashtëm, që të na përkrahë për përpunimin dhe këshillat për ta kompletuar Ligjin e Punës. Ideja është që ky të përfundojë deri në fund të korrikut dhe unë do të jap gjithë kontributin tim, që ta kryejmë këtë Ligj e të mos na mbetet pas pushimeve. Pra, të punojmë të gjithë, e kemi për detyrë ta përfundojmë.

Sadik Idriz- Jam i mendimit që deri më 26 - 27 ta caktojmë dëgjimin publik. Është mirë që të mos harrojmë ta ftojme ndonjë palë të interesuar. Është mirë që ta përshpejtojmë organizimin e vizitës në Slloveni. Pra, së pari do të kemi dëgjim publik, pastaj vizitën në Slloveni e pastaj do të përfundojmë më amendamente.

Gjithashtu kemi marrë një letër nga Haxhi Arifi , kryetari i BSPK, rreth asaj se puna në ditë vlen një cent. Kjo edhe mund të jetë ashtu, por për mua kjo është e sigurtë. Ne kemi nevojë të punojmë për këtë Ligj, të marrim informacione, të bisedojmë me Qeverinë në mënyrë serioze edhe të kërkojmë zgjidhje. Projektligji ka ardhur me vonesë, nuk është i përkryer, ka defekte, mirëpo ne duhet të angazhohemi ta përmirësojmë tekstin që e kemi marrë. Të punojmë, secili ta japë kontributin e vet, e jo ta përdorim për përfitime ditore. Si Komision deri tash kemi punuar shumë mirë dhe nuk kemi pasur dallime partiake dhe do të vazhdojmë në këtë mënyrë.

Flora Brovina- Pajtohem se nuk e kemi pasur dhe do të kemi atmosferë mbipartiake për Ligjin, sepse edhe diskutimet në Parlament kanë qenë korrekte dhe shumë në favor të këtij Ligji. Gjithashtu, është punuar edhe me ekspertë dhe kemi shumë arsye mos të na pëlqejë një Ligj më i dobët sesa ai që ka qenë. Nuk e meritojnë punëtorët tanë, që janë të diskriminuar aq gjatë, një Ligj prapë diskriminues, me një arsyetim jo shumë të mirë që e dha ministri i Financave. Insistoj që, para se të shkojmë në Slloveni dhe para se të organizojmë debatin publik, ta takojmë ministrin e Financave, pasi që për ministrin e punës nuk kemi nevojë. Më intereson ta shoh variantin që ministri i Punës ia ka dorëzuar Qeverisë, sepse ai nuk e kishte këtë shumë të financave për këtë Ligj. Është mirë ta shohim se sa ka qenë ajo shumë, sepse mund të jetë shumë e rritur por ne duhet ta gjejmë dikund mesin, që sigurisht do të gjindet pasi të bisedojmë me ministrin për Financa dhe me FMN. Pa e ndryshuar koston, nuk kemi se si ta përmirësojmë Ligjin dhe amendamentet e tona është sikur t'i hedhim në ujë.

Sadik Idriz- Ne javën tjetër do ta kemi ministrin e Punës këtu, për të biseduar për dy çështje që kanë të bëjnë me pensionistët tanë në Zvicërr dhe me Raportin e Progresit, dhe mund ta pyesim edhe për Ligjin e punës. Është me rëndësi ta kemi në dëgjim publik edhe Ministrinë e

Financave. Duhet shikuar mundësin e zgjatjes së pushimit të lehonisë, sepse unë nuk e votoj këtë Ligji me tre muaj pushim të lehonisë, sepse është shumë restriktive.

Flora Brovina- Tha se insistoј që ministrin e Financave të kontaktojmë më herët, sepse në dëgjim publik do të na e merr fjalën kryesore dhe do ta mbizotërojë debatin.

Sadik Idriz- Tha se ne mund t'i ftojme pas dëgjimit publik të dy ministrat në Komision, që të shpjegojnë se ku jemi më këto deklarime financiare.

Gjylnaze Syla- Kemi një listë shumë gjithpërfshirëse të të ftuarve për dëgjim publik dhe është mirë që nëse dikush ka edhe ndonjë propozim tjetër ta thotë, në mënyrë që ta plotësojmë edhe më shumë listën e të ftuarve, dhe të kemi edhe vërejtjet e tyre me shkrim. Komisioni nuk duhet të merret me çështjen se a ka Ministria buxhet apo nuk ka? Komisioni duhet ta kryejë punën e vet, konform interesit të grave, t'ia dërgojë Komisionit për Buxhet amendamentet, e pastaj ata le të merren me çështjen buxhetore.

Sadik Idriz- Tha se Emrush Xhemajli, ka sjellë disa amndamente. Ai do të jetë prezent edhe në dëgjim publik, është i interesuar si Parti Socialiste të bëj amendamente. Për neve kjo është e mirëseardhur.

Vezira Emrush- Kur flasim për Ligjin e Punës duhet të jemi të gjitha aktiv dhe të japim propozime konkrete, sepse sikur të gjithë e dijmë se Ligji i ka 12 kapituj, dhe gjithsej 96 nene. Disa nene janë kapërcyer, nuk e di nëse kjo është bërë me qëllim ose jo, ne duhet këtë ta vërtetojmë. Ligji nuk e ka gjendjen faktike, mbrojtjen e fëmijëve, mbrojtjen e grave, nuk e ka mbrojtjen e punëtorëve, dhe duhet bërë dallim në mes kontratës kolektive dhe kontratës së punës. E them këtë për kontratën kolektive, sepse në Kosovë gjithçka është privatizuar në mënyrë të egër dhe punëtorët nga ndërmarrjet shoqërore praktikisht janë përzënë. Këtë duhet ta pranojmë dhe ta thojmë.

Unë kam dhënë vërejtjet e mia edhe në seancë por atje kam pasur shumë pak kohë dhe nuk kam mundur t'i them të gjitha. Ligji sa më shumë nene ka, aq më tepër fusha i rregullon. Shumë herë e kam përsëritur, e rëndësishme për Kosovën është lidhja e stazhit të punës. Ligji ynë nuk e ka këtë. Në këto gjëra duhet të kemi shumë kujdes, nuk bën të dëmtohen njerëzit. Njerëzit patjetër duhet të shkojnë në pension. Projektligji nuk e parasheh as pagën minimale.

Sadik Idriz- Tha se sot më shumë po bisedojmë për çështje teknike, për mënyrën se si do të punojmë.

Nurishahe Hulaj - Ne jemi ligjvënës. Nga përvojat e rajonit dhe kontakteve që kemi pasur, roli ynë është të evokojmë, sepse nëse nuk e bëjmë një gjë të tillë nuk kemi për ta pasur. Konsideroj që këtë do ta përkrahë edhe Qeveria dhe do të jetë në shqyrtim Korniza afatmesme e buxhetit 2011 - 2013, ku ne të gjithë aty mund të japim kontributin dhe të kërkojmë mjete shtesë për këtë ligj.

Mbledhja përfundoi në orën 14:10

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Sadik Idriz